



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:103185

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06095014

PPP.nr.20/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Adelina Jusufi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike Sh.A. (KESco), me seli në Bulevardi “Bill Klinton”, Nr.5, Prishtinë, kundër debitorit B. (S.) A. nga fshati G..., Komuna e P..., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Isa Shala në Prishtinë, P.nr.57/20 të datës 24.02.2020, jashtë seancës, me datë 28.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit B. (S.) A. nga fshati G..., Komuna e P..., **SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.57/20 të datës 24.02.2020 dhe **OBLIGOHET** debitori B. (S.) A. nga fshati G..., Komuna e P..., që në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike Sh.A. (KESco), me seli në Bulevardi “Bill Klinton”, Nr.5, Prishtinë në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike për periudhën 10.01.2019 deri me 09.01.2020 t’ia paguaj shumën prej 263.33 €uro, me kamatë ligjore, vjetore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim, deri në pagesën definitive të borxhit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesës së kreditorit në shumë prej 1,231.59 €uro për periudhën nga data 05.01.2014 deri me datë 09.12.2018.

A r s y e t i m

Kreditore Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike Sh.A. (KESco), me seli në Bulevardi “Bill Klinton”, Nr.5, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstraktit nga librat afarist, ka parashtruar propozim për përmbarim pranë Përmbaruesit Privat Isa Shala në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori B. (S.) A. nga fshati G..., Komuna e P..., që në emër borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike për periudhën prej 05.01.2014 deri me 09.01.2020, ta paguaj shumën prej 1,494.92 Euro me kamatë ligjore, vjetore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbaruesi privat Isa Shala, më Urdhrin P.nr.57/20 të datës 24.02.2020 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat, dhe e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e përmbaruesit privat me pretendimet se borxhi i kërkuar nga kreditore është parashkruar dhe vetëm borxhi prej datës 24.02.2019 nuk është parashkruar duke e bazuar në nenin 360 par.1 të LMD-së, duke i propozuar gjykatës që prapësimin ta pranoj si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhërin.

Kreditore ka parashtruar përgjigje në prapësim duke pretenduar se tek Kriteri Minimal është i precizuar borxhi kumulativ jo i ndarë nga faturë për faturë mujore, duke shtuar se borxhi i krijuar nuk është parashkruar pasi që debitori ka pranuar borxhin konform LMD-së duke bërë pagesa në emër të borxhit me datë 27.01.2020 në vlerë prej 30€, e cila pagesa shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhër.

Gjykata, me aktvendimin PPP.nr.51/20 të datës 24.06.2020 ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.57/20 të datës 24.02.2020. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila përmes aktvendimit AC.nr.4071/2020 të datës 19.04.2021 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit duke e kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë me arsyet si në aktvendimin e mësipërm.

Gjykata, në rivendosje me aktvendimin PPP.nr.675/21 të datës 16.02.2022 ka hedhur poshtë propozimin e kreditorit. Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila përmes aktvendimit AC.nr.4659/2022 të datës 30.05.2024 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit duke e kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë me arsyet si në aktvendimin e mësipërm.

Gjykata, pas kthimit të çështjes në rivendosje, dhe pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim nga ana e kreditorit, e në raport me provat në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pjesërisht i bazuar për këto arsyeje: Sipas vlerësimit të gjykatës, dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, pra, Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me shifër DPR-73607, është dokument i besueshëm konform nenit 29, par. 1, pika 1.2 të Ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku parashihet “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave: dhe po ai ekstrakt, bazuar në nenin 29 par.3 i cili parasheh “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.” është i përshtatshëm për përmbarim pasi që në të njëjtin është treguar kreditori, debitori, objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes.

Po ashtu, propozimi për përmbarim është paraqitur konform nenit 37, i Ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili parasheh “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”, pra propozimi për përmbarim përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me nenin 37 të LPP-së.

Gjykata lidhur me pretendimin e debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar, gjeti se i njëjti është pjesërisht i bazuar për faktin se borxhi i krijuar për debitorin për periudhën prej 05.01.2014 deri me datë 09.12.2018 në shumë prej 1,231.59 Euro është borxh i parashkruar konform nenit 360, par.1, nën par. 1.1 Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku parashihet “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat

shtëpiake”, ndërsa sa i përket rrjedhjes së afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të të njëjtit ligj parashihet “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrihet kërkesa për pagesë”.

Tutje, gjykata vlerëson se në rastin konkret edhe pse debitori ka kryer pagesa të një këstit me datë 27.01.2020, nuk ka bërë pranimin e borxhin, për faktin se nëni 368 par.1 parasheh “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin” ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.” e që sipas gjykatës, pagesat e kohëpaskohshme, paushalle, në formë të kësteve, pa specifikuar se për cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, nuk shkaktojnë ndërprerjen e parashkrimit, kjo për faktin se pagesa e borxhit në formë të kësteve mund të vijë në shprehje vetëm pas një marrëveshje (kontrate) për pagesën (ri programimin) e borxhit ndërmjet kreditorit dhe debitorit, e që në rastin konkret në shkresat e lëndës nuk ka prova se një marrëveshje (kontratë) e tillë ekziston ndërmjet palëve, dhe nuk ka asnjë provë tjetër e cila do të mund të konsiderohej si pranimit i borxhit nga ana e debitorit.

Për më tepër edhe Gjykata Supreme përmes aktgjykimit Rev.nr.148/2012 të datës 09.09.2013 (faqe 3, paragrafi 4) ka mbajtur qëndrimin se pagesat paushalle, të kohëpaskohshme, për të cilat nuk është specifikuar asnjëherë se për cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit.

Gjykata gjeti se debitori për periudhën 10.01.2019 deri me 09.01.2020 në shumë prej 263.33 Euro, është i bazuar dhe se nuk është parashkruar duke pasur parasysh dispozitën e nenit 360.2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve me të cilën parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2019, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga 01.01.2020, dhe për të gjitha kërkesat e arritura gjatë vitit 2020, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë me 01.01.2021, ndërsa, në rastin konkret, kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbartim me datën 24.02.2020 ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2019 dhe 2020.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera si në prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim nga ana e kreditorit mirëpo të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore, iu referua nenit 382,par.1 dhe 2 te Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykata, ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes se kamatëvonesës i referohet mendimit juridik te Gjykatës Supreme te Kosovës nr. 265/20, dt. 01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI te këtij mendimi. dhe gjeti se debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, nga data kur është ushtruar propozimi për përmbarim e tutje.

Gjykata, bazuar në nenin 43 par.4, në lidhje me nenin 71 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.20/24, me datë 28.08.2024

Gj y q t a r j a

Adelina Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.